



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 195, datë 27.09.2018

PËR
MIRATIMIN E NJË SHTESE NË RREGULLOREN
NR. 129, DATË 26.11.2015 “PËR MARRËDHËNIET E PUNËS TË PUNONJËSVE NË
AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE, E NDRYSHUAR

Në bazë të nenit 14, pika 12, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, e ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, e ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Në pjesën e II-kushtet dhe procedurat e pranimit në punë, pas nenit 6-kërkesat specifike dhe procedura e pranimit në punë si punonjës i Autoritetit, shtohet një nen i ri 6/1, me titull dhe përmbajtje si vijon:

“Neni 6/1

Kriteret dhe procedura për pozicionin e punës kryespecialist në Autoritet

I. Kriteret:

- a. Të ketë përvojën e punës mbi 6 vjet në Autoritet;
- b. Të ketë vlerësime të rezultateve në punë të tre viteve të fundit në nivelin “Shumë mirë”;
- c. Të mos ketë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës në tre vitet e fundit;
- d. Të kalojë nivelin 70% të testit (me shkrim).

II. Procedura:

- a. Punonjësi paraqit kërkesën drejtuar eprorit/ëve të drejtpërdrejtë dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse/Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, në të cilën paraqitet një përmbledhje e shkurtër e punës në pozicionin/pozicionet e mbajtura në Autoritet, progresin e bërë gjatë viteve të punës në AMF, rezultatet e tij në punë mbështetur në vlerësimet e punës. Kërkesa e punonjësit duhet të shoqërohet dhe me një Curriculum Vitae të përditësuar në gjuhën shqipe.
- b. Me marrjen e kërkesës, eprorët aktual të punonjësit sipas linjës hierarike brenda 7 ditëve paraqesin tek Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse/Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivës një raport/opinion të arsyetuar me shkrim për ecurinë dhe arritjet në punë të punonjësit. Raporti duhet të përmbajë dhe tregues konkret, aty ku është e mundur, si dhe elementë që mund të dëshmojnë dëshirën për zhvillim profesional të punonjësit apo dhe elementë të etikës në punë.
- c. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse/Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkivës me marrjen e kërkesës për aplikim, brenda 7 ditëve verifikon plotësimin e kriterëve dhe vë në dispozicion të punonjësit çdo dokument mbështetës.
- d. Pas plotësimit të kriterëve a), b) dhe c) punonjësi do t’i nënshtrohet testit me shkrim. Testi do të përfshijë pyetje të karakterit të përgjithshëm (kryesisht bazë ligjore dhe rregullative të insitucionit dhe njësive përkatëse) dhe pyetje teknike sipas fushave përkatëse.
- e. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv miraton rast pas rasti procedurën e testimit dhe komisionin e vlerësimit.
- f. Korrigjimi i testeve do të kryhet nga një komision i brendshëm vlerësimi , me të paktën 3 punonjës ku dy prej tyre duhet të jenë eprorë të punonjësit që ka shprehur kërkesën. Afati i korrigjimit të testeve dhe daljes së rezultateve është 7 ditë nga data e zhvillimit të testimit.

- g. Pas shpalljes së rezultateve finale të testit, nëse nuk ka ankesa, Sektori i Burimeve Njerëzore nëpërmjet Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse/ Drejtorit të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, përgatit raportin drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv brenda 7 ditëve.
- h. Bazuar në praktikën e paraqitur, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv miraton emërimin e punonjësit në pozicionin “Kryespecialist”.
- i. Në rast se punonjësi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 6/1, pika I, për pozicionin e punës “Kryespecialist”, e drejta për të aplikuar sërish, i lind pas një viti nga aplikimi i fundit.”